



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:178063
Datë: 21.03.2025
Numri i dokumentit: 07023005

Ac.nr.8021/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Besnik Bislimaj dhe Bujar Muzaqi, anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Xhennet Shantir, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.R nga Gjakova, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë Agron Krasniqi dhe Martin Komani, avokatë nga Prishtina, kundër të paditurit Spitali i Përgjithshëm “I.G” në Gjakovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Valdete Rudi, me objekt kontesti kompensim i pagës jubilarë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.****/20, të datës 21.06.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.03.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e të paditurit Spitali i Përgjithshëm “I.G” në Gjakovë, NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.****/20, të datës 21.06.2022 në pikën I (një) të dispozitivit të aktgjykimit dhe çështja gjykohet si në vijim:

I.REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit B.R nga Gjakova, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri Spitali i Përgjithshëm “I.G” në Gjakovë, që paditësit në emër të shpërblimit jubilar t’ia paguajë vlerën e një page bazë dhe atë shumën prej 425.00 € (katërqind e njëzet e pesë euro), me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloj të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë deri në pagesën definitive si dhe t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

III. Pika II e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar mbetet e pashqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.****/20, i datës 21.06.2022, në pikën I (një) të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditësit B.R nga Gjakova dhe e ka detyruar të paditurin Spitali i Përgjithshëm “I.G” në Gjakovë, që paditësit në emër të shpërblimit jubilar t’ia paguajë vlerën e një page bazë dhe atë shumën prej 425.00 € (katërqind e njëzet e pesë euro), me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloj të llogaritet nga data 16.12.2020 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 259,00.-€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit. Në pikën II (dy) të dispozitivit të aktgjykimit e ka refuzuar si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit mbi shumën e aprovuar sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar dhe atë në emër të shpërblimit jubilar në shumën prej 426.18.-€.

Kundër këtij aktgjykimi, në drejtim të pjesës aprovuese të kërkesëpadisë, ankesë ka paraqitur i padituri për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën dhe aktgjykimin e atakuar në pikën II të dispozitivit ta ndryshoj dhe ta refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi B.R nga Gjakova, me datë 16.12.2020 ka paraqitur padi kundër të paditurit Spitali i Përgjithshëm “I.G”, me seli në Gjakovë, duke kërkuar kompensimin e shpërblimit jubilar, bazuar në Ligjin e Punës dhe Kontratën Kolektive të Sektorit të Shëndetësisë dhe atë në nenin 17 paragrafi 1 pika 3.1 të saj, me arsyet sikurse në padi. I autorizuari i paditësit në seancën e shqyrtimi kryesor me datë 21.06.2022, ka bërë rregullimin e padisë në kuptim objektiv, ashtu që ka precizuar lartësinë e kërkesëpadisë si në vijim : Obligohet Spitali i Përgjithshëm “I.G”, që për 16 vite përvojë pune të ia paguaj paditësit një pagë jubilarë në shumë prej 851.81€, me kamatë ligjore prej 8 % nga data e paraqitjes së padisë, andaj mbi bazën e të lartcekurave ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar sipas precizimit të bërë në seancë.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë, pas plotësimit të kushteve procedurale ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, në të cilën pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.****/20, të datës 21.06.2022, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht të

bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se nga provat e administruara dhe të elaboruara rezulton se paditësi tek i padituri i ka mbi 10 vite përvojë pune, fakt ky i provuar nga vërtetimi i marrëdhënies së punës i datës 10.02.2020 i lëshuar nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – Spitali i Përgjithshëm “I.G” në Gjakovë dhe rrjedhimisht i njëjti i ka plotësuar kushtet e parapara me nenin 17 paragrafi 3 pika 3.1 të KKS-së, për të qenë përfitues i shpërblimit jubilar në vlerë të një page bazë, të cilat të njëjtit nuk i janë paguar nga ana e të paditurit. Lartësinë e pagesë bazë në shumë prej 425.00€, gjykata e vërtetoi sipas listës së pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Ka shtuar se duke qenë se paditësi ka të drejtën ligjore për shpërblim jubilar, i njëjti është legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga i padituri, në kuptim të nenit 245 të LMD-së, në lartësinë e një page bazë që ka realizuar në muajin e fundit nga marrëdhënia e punës tek i padituri. Ndërsa refuzimin e kërkesëpadisë përtej shumës së gjykuar e arsyetoi duke u bazuar në nenin 55 paragrafi 2 të Ligjit të Punës, i cili parasheh se: *“I punësuari ka të drejtë për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës”*. Në anën tjetër, neni 17 paragrafi 3 pika 3.1 i KKS-së, parasheh se i punësuari ka të drejtë e realizimit të një page mujore, e që nuk i përfshinë shtesat tjera nga paga. Pra sipas gjykatës së shkallës së parë ky përcaktim ligjor nga ky nen, ndan atë çka nënkupton pagë dhe shtesa nga paga. Mbi këtë bazë gjykata e ka refuzuar pjesën e kërkesëpadisë përtej shumës nga pika I (një) e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, përkatësisht shumën në lartësi prej 426.18€, pasi që ka vlerësuar se paditësit i takon një pagë bazë e paraparë si në listën e pagave, dhe jo duke përfshirë shtesat që i ka pranuar nga i padituri (siç janë: shujtat, shtesat për Covid-19 dhe kujdestaria). Kjo për faktin se shtesat tjera nga paga, të punësuarit i takojnë kur ai gjatë angazhimit në detyra të punës arrin të realizoj shtesat në ushqim, punë jashtë orari, kujdestari etj. Andaj mbi këtë bazë vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sa i përket vlerësimit të themelësisë së kërkesëpadisë, gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitës së nenit 4 paragrafi 1, nenit 17 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 lidhur me paragrafin 4 të Kontratës Kolektive Sektoriale në Kosovë (KKS), të miratuar dhe të nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës me datën 11.06.2018. Vendimin mbi kamatën ligjore, gjykata e shkallës së parë e ka mbështetur në nenin 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, ndërsa vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës në nenin 449 dhe 452 paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit duke shqyrtuar ankesën e palës së paditur brenda kufijve të saj, por duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, si dhe për zbatimin e të drejtës materiale, vjen në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat gjykata e shkallës së dytë i vëren sipas detyrës zyrtare, gjendja faktike është konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, por gjykata e shkallës së

parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, për këtë gjë u desh që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të gjykohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit nuk e përkrahë qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me mënyrën se si është aplikuar e drejta materiale në raport me vlerësimin e themelësisë së kërkesëpadisë në këtë çështje juridike. Me rastin e vlerësimit të fakteve vendimtare, fillimisht duhet theksuar se nuk ishte kontestues fakti që paditësi është në marrëdhënie pune tek i padituri që nga data 01.12.2004, në pozitën si infermier në shërbimin e emergjencës, fakt ky i cili vërtetohet edhe nga vërtetimi i datës 10.02.2020, i lëshuar nga i padituri. Po ashtu nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka 16 vite përvojë pune të pandërprerë tek i padituri. Gjykata kishte vërtetuar edhe faktin se paditësi kishte realizuar pagë mujore prej 425.00 €.

Megjithatë, paditësi bazën ligjore të kërkesëpadisë e ka mbështetur në Kontratën Kolektive Sektoriale në Kosovë (KKS) të miratuar dhe të nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës me datën 11.06.2018. Dispozita nga neni 36 paragrafi 1 të kësaj Kontrate parasheh se: *“Kontrata Kolektive Sektoriale hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga ana e palëve nënshkruese”*, rrjedhimisht nga data 11.06.2018, data në të cilën është nënshkruar kjo kontratë. Në anën tjetër, dispozita e nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, parasheh se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”*.

Këto dispozita përcaktojnë të drejtën e punëtorit për shpërblim jubilar, mirëpo në rastin konkret themelësia e kërkesëpadisë nuk ka mundur të mbështetet në këtë dispozitë për shkak se Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë në Kosovë ka filluar të zbatohet nga data 11.06.2018 me kohëzgjatje të zbatimit për tri vite, përkatësisht deri me datën 11.06.2021, kur të njëjtës i ka skaduar afati i zbatimit përkatësisht i ka pushuar efekti juridik.

Në kuptim të kësaj, meqë nga vërtetimi i lëshuar për paditësin i datës 10.02.2020, vërtetohet se i njëjti është në marrëdhënie pune tek i padituri nga data 01.12.2004 dhe se në momentin e ushtrimit të padisë në gjykatë me datë 16.12.2020, ka përmbushur 16 vjet përvojë pune, nga kjo rezulton se paditësi kushtin për shpërblim jubilar për 10 vite të përvojës së punës së pandërprerë e ka arritur para hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë në Kosovë, gjegjësisht me datë 01.12.2014. Nga kjo rezulton se kushti për shpërblim jubilar është përmbushur në një periudhë kohore në të cilën Kontrata e lartcekur nuk ka qenë në fuqi dhe si e tillë nuk mund të prodhojë efekt juridik, gjegjësisht të aplikohet në mënyrë retroaktive, e nga kjo rezulton se paditësit i mungon baza ligjore për realizimin e kërkesës së parashtruar në padi.

Në rastin konkret kërkesa e paditësit nuk gjen mbështetje as në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, të lidhur dhe nënshkruar nga Organizatat e Punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të Punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës) dhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Dispozita nga neni 82 e kësaj Marrëveshje parasheh se: *“Kjo Marrëveshje e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e nënshkruar nga Partnerët në Këshillin Ekonomiko – Social të Kosovës, hyn në fuqi nga data 01.01.2015”*. Andaj bazuar edhe në këtë dispozitë, paditësit i mungon baza ligjore për

realizimin e kërkesëpadisë, ngase Marrëveshja e lartcekur nuk ka qenë në fuqi në periudhën kohore të arritjes së jubilaritetit dhe e njëjta nuk mund të zbatohet në mënyrë retroaktive.

Rrjedhimisht meqenëse në rastin konkret në momentin kur paditësi ka realizuar 10 vite të përvojës në punë tek i padituri, një e drejtë e tillë, nuk ishte përcaktuar me ndonjë akt normativ të punëdhënësit, kontratë të punës apo marrëveshje kolektive, nga këto arsye gjykata ankimore duke vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit për shpërblim jubilar nuk ka bazë ligjore, me referim në dispozitën e nenit 195 paragrafi 1 pika e), lidhur me nenin 201 paragrafi 1, pika d) të LPK-së vendosi që aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj me refuzimin e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit, vendimin për shpenzimet e procedurës, që secila palë t'i bart shpenzimet e saj të procedurës, e ka bazuar në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

Aktgjykimi i ankimuar në pikën II të dispozitivit nuk është shqyrtuar nga ana e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që në këtë pjesë nuk është goditur nga pala ankuese.

Nga të cekurat më lart, e duke u bazuar në dispozitat nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika e), lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.8021/2022, me datë 19.03.2025.

Bashkëpunëtorja profesionale,
Xhennet Shantir

Kryetarja e kolegjit,
Halide Reka d.v

Numri i lëndës: 2020:178063
Datë: 21.03.2025
Numri i dokumentit: 07023005